



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.82, datë 24.04.2023

PËR

“TRANSFERIMIN E PËRHERSHËM PA PËLQIM TË PROKURORËVE NGA PROKURORITË PRANË GJYKATAVE TË SHKALLËVE TË PARA TË CILAT SHKRIHEN PËR EFEKT RISTRUKTURIMI”

Bazuar në nenin 149/a pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 44 pika 1 germa “b” dhe pika 2 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” dhe pika 2 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e Rretheve Gjyqësore dhe kompetencave tokësore të Gjykatave”, Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm Nr.54, datë 18.04.2023 “Për caktimin e strukturës organike të prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para dhe Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm” me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Transferimin e përhershëm të prokurorëve Abaz Muça dhe Alma Bramo, në pozicionin e prokurorit në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Dibër.
2. Transferimin e përhershëm të prokurorëve Merita Selimi, Denis Hyka, Arben Dyla (aktualisht i pezulluar nga KPK) dhe Artan Hazbiu (aktualisht i pezulluar nga KPK), në pozicionin e prokurorit në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Fier.
3. Transferimin e përhershëm të prokurorëve Asllan Bajramaj dhe Silvana Pani (aktualisht e pezulluar nga KPK), në pozicionin e prokurorit në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Gjirokastrë.
4. Transferimin e përhershëm të prokurorëve Arben Nika, Bardhyl Shehu dhe Matilda Fetau, në pozicionin e prokurorit në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Lezhë.
5. Transferimin e përhershëm të prokurorit Alban Syri, në pozicionin e prokurorit në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Korçë.
6. Transferimin e përhershëm të prokurorëve Artan Shtrungza, Armida Kaçi dhe Agim Dalipaj (aktualisht i pezulluar nga KPK), në pozicionin e prokurorit në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Kukës.
7. Transferimin e përhershëm të prokurorëve Pjerind Çukaj dhe Elidjana Morina (Kasaj), në pozicionin e prokurorit në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Shkodër.

8. Transferimin e përhershëm të prokurorëve Petrit Çano, Florian Boriçi, Eliora Elezi, Florjan Bonjaku, Mirela Kapo dhe Olgert Rumnici, në pozicionin e prokurorit në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë.
9. Transferimin e përhershëm të prokurorëve Gëzim Çoba dhe Mediana Meta, në pozicionin e prokurorit në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës.
10. Transferimin e përhershëm të prokurorit Durim Bedini, në pozicionin e prokurorit në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan.
11. Transferimin e përhershëm të prokurorëve Esmeralda Keshi dhe Eloida Goxhi, në pozicionin e prokurorit në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë.
12. Ndërprerjen e transferimit dhe caktimit të përkohshëm të prokurorit Eljon Mustafaj në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Lushnje dhe kthimin e tij në prokurorinë pranë gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm Vlorë.
13. Ndërprerjen e transferimit dhe caktimit të përkohshëm të prokurorit Neritan Hoxha në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec dhe kthimin e tij në prokurorinë pranë gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm Elbasan.
14. Të njoftohen për këtë vendim, Prokurori i Përgjithshëm, si dhe të gjitha subjektet dhe prokuroritë që përmenden në këtë vendim.
15. Efektet e këtij vendimi, fillojnë në datë 01.05.2023, përveç pikës 11 të këtij vendimi, e cila i fillon efektet me datë 19.12.2023.
16. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
17. U shpall në Tiranë, sot më 24.04.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR

Alfred Balla

ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Mirela Bogdani

ANËTAR

Bujar Sheshi

ANËTAR

Ledina Riza

ANËTAR

Arta Mandro

ZV/KRYETAR

Tartar Bazaj

ANËTAR

Nurihan Seiti

ANËTAR

Zeqir Hoda